VENDIM
Nr.871, datë 22.12.2004

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I DY REZERVUARËVE TË UJIT TË PIJSHËM, NË KUADËR TË PROJEKTIT PËR ZONËN RURALE TË QYTETIT TË DURRËSIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik" dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004", me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilët preken nga ndërtimi i dy rezervuarëve të ujit të pijshëm, në kuadër të projektit për zonën rurale të qytetit të Durrësit.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të ujësjellës-kanalizimeve sh.a., Durrës.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 2 675 m tokë arë, e vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 2 915 000 (dy milionë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekësh.

4. Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2004, zëri "Investime për projektin me fondet e OPEC-ut", miratuar për Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të jetë në shumën 245 500 (dyqind e dyzet e pesë mijë e pesëqind) lekë dhe të përballohet nga ujësjellës-kanalizime sh.a., Durrës.

6. Punimet të përfundojnë brenda muajit prill 2005.

7. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë brenda muajit dhjetor 2004.

8. Ngarkohen Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit dhe ujësjellës-kanalizime sh.a., Durrës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

LISTA E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR NDËRTIMIN E DY REZERVUARËVE TË UJIT TË PIJSHËM NË KUADËR TË PROJEKTIT PËR ZONËN RURALE

TË QYTETIT TË DURRËSIT

PRONARËT QË DO TË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I REZERVUARIT TË UJIT TË PIJSHËM NË FSHATIN KATUND I RI

Nr.	Emri mbiemri	Sip/toke are	Çmimi tokës/m^2 (lekë)	Vlera në (lekë)
1.	Z.Vath Çyrbja	1400 m^2	1150	1 610 000
2.	Z.Hysen Çyrbja	1200 m^2	1150	230 000
Totali/lekë				1 840 000

PRONARI QË DO TË SHPRONËSOHET NGA NDËRTIMI I REZERVUARIT TË UJIT TË PIJSHËM NË FSHATIN MANËZ TË BASHKISË KAMËZ

Nr.	Emri mbiemri	Sip/toke are	Çmimi i objektit/m^2 (lekë)	Vlera në (lekë)
1.	Qamil Kurti	1075	1000	1 075 000

Vlera totale e shpronësimit është 2 915 000 (dy milionë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë.